

## Historiku i Institucioni Parashkollor “Çerdhja”

Qendra është themeluar me vendimin e BVI-së për mbrojtjen sociale të Lipjanit nr.16 të datës 10.07.1975.v. dhe në të njëjtin vendim ka dhënë pëlqimin Kuvendi komunal i Lipjanit me vendimin nr. 612-020 të datës 29.07.1975.v. Qendra është regjistruar në Gjyqin ekonomik të qarkut në Prishtinë me vendim nr. FI-382/76 të datës 5.07.1976.v. si QENDER PER EDUKIMIN E FEMIJEVE NË LIPJAN.

Kështu që me hyrjen në fuqi të Ligjit mbi punën e bashkuar, Qendra bënë harmonizimin e akteve normative dhe me 09.03.1975.v. përsëri regjistrohet në gjyqin ekonomik të qarkut në Prishtinë, me vendimin nr.FI-493/78 si **QËNDËR PËR EDUKIMIN DHE ARSIMIMIN PARASHKOLLOR TË FËMIJËVE NË LIPJAN** të cilin emër e mbanë edhe sot. Drejtor i qendrës ishte emëruar **Gjurgjiana Dejanoviqi**.

Institucioni Parashkollor “Çerdhja” është i vetmi institucion shtetëror në Komunën e Lipjanit, që përkujdeset për edukimin e fëmijëve të moshës 1 deri në 6 vjeç. Është themeluar në vitin 1975 me vendimin nr.16 të datës 10.07.1975, për nga standardet i ka plotësuar të gjitha kushtet për një mësimdhënie të suksesshme.

Në fillim të punës ka pasur 63 fëmijë 5 dhoma, prej tyre vetëm 6 fëmijë shqiptarë .Ndërsa numri i punëtorëve gjithsej ka qenë 21, prej tyre vetëm 6 shqiptarë dhe një rom , të tjerët të nacionalitetit serb. Me 1992 pushteti i atëhershëm dëboi fëmijët dhe punëtorët shqiptarë nga kopshti.

Ndërsa në vitin 1999 pas përfundimit të luftës në Kosovën e lirë ,të gjithë fëmijët dhe punëtorët e dëbuar përsëri janë kthyer në këtë institucion ku si drejtor i këtij institucioni me datë: **15.08.2000** emërohet **Milazim Shamolli** deri më datë **15.08.2001** ku e ka ndërpre punën. Pas tij si drejtor për udhëheqjen e IP-së me datë: **01.11.2001** e deri në pensionim me datë **15.10.2017** ka qenë **Xhemaj Fazliu**. Si pasardhës pas pensionimit të drejtorit me datë: **25.10.2017** emërohet **Biha Azemi** e cila edhe më tutje është duke udhëhequr me këtë institucion.

IP. tani posedon dy objekte: **Objekt i Vjetër** i cili ka **640 m<sup>2</sup>** lokal të mbyllur në të cilin mund të vendosen deri në 100 fëmijë dhe **Objekti i Ri** është lëshuar të punoi më **01.09.2020** dhe disponon **1865.048m<sup>2</sup>** lokal te mbyllur ne te cilin gjithashtu mund te vendosen mbi 100 fëmijë të grup moshave të ndryshme.

Në IP. tani kemi gjithsej 10 grupe fëmijësh: **4 grupe çerdhesh dhe 6 grupe kopshti me gjithsej 200fëmijë**. Mësimi zhvillohet në dy ndërrime. Me një staf prej **33** punëtorëve prej tyre janë **12 Edukatore dhe 8 Motra Edukatore**. Puna fillon prej orës **7.00– 16.00** .IP posedon edhe kuzhinën në të cilën fëmijët ushqehen me shujta të ngrohta 2 herë në ditë dhe pas gjumit ushqehen edhe për zamër. Puna e planifikuar edukativo- arsimore realizohet prej 1 shtatorit e deri më 31 qershor të vitit shkollor.

QEAP “ Çerdhja” – Lipjan, punon 11 muaj të vitit kalendarik dhe 1 muaj pushon në formë kolektive, në mënyrë që të kryhen punë të ndryshme dhe të domosdoshme në institucion (renovim, meremetim dezinfektim, dezinfektim, deratizim dhe pastrim gjeneral të objektit).Gjatë periudhës, një (1) Korrik deri më pesëmbëdhjetë (15) Korrik të vitit akademik, për arsye të zvogëlimit të numrit të fëmijëve, planifikohen dhe organizohen aktivitete të lira të planifikuara në hapësirë të mbyllur dhe të hapur – çdo herë duke e respektuar personalitetin dhe dëshirën e fëmijëve. Në rast të fatkeqësive natyrore, ku cenohet jeta e fëmijëve dhe pasuria e Institucionit, ose kur fatkeqësia parashihet (pritet), atëherë orari i punës së punëtorëve adaptohet sipas situatës së krijuar;

Kuadri është i kualifikuar për punën që bënë, pjesërisht i trajnuar, ku lypset gjithmonë për të pasur një mësimdhënie dhe mësim nxënie sa ma cilësore në përdorimin e metodologjisë dhe teknikave të reja mësimore.

## **Historiku i Institucioni Parashkollor “Çerdhja”**

Për realizimin e programit vjetor të punës për punëtorët administrativ, personelin teknik dhe ndihmës, vlen orari i punës 40 (dyzet) orë pune në javë. Ndërkaq për personelin edukativ gjithashtu 40 (dyzet) orë në javë por të ndara: në 6+2 (gjashtë orë punë direkt me fëmijë dhe dy orë parapërgatitje për punë duke e llogaritur këtu edhe pauzën);

Mësimi në IP. për shkak të pandemis me Covid-19 është zhvilluar sipas Skenarit A të përgatitur nga MASHT-të por sipas nevojës edhe sipas Skenarit C d.m.th. me mësim online.

Që puna të zhvillohet pa probleme është formuar edhe grupi i TASK FORCES i cili do monitoroi çdo herë zhvillimin e punës në IP dhe nëse paraqitet nevoja për shkak të pandemis Covid-19 do të jepen udhëzime për zhvillimin e mëtejshëm të mësimit duke u harmonizuar gjithmonë me TASK FORCEN e DKA-së .